

MODERNJA DHE TRADICIONALJA NË JETËN E PËRDITSHME NË VUSHTRRI

EKSPOZE E PUNIMIT MASTER

NGA

Alberita Jashari



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË

STUDIME PASUNIVERSITARE – MASTER

PRISHTINË

2023

MODERNJA DHE TRADICIONALJA NË JETËN E PËRDITSHME NË VUSHTRRI

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Ibrahim Berisha

Kandidatja: Alberita Jashari

Ky punim eksploron konceptet e modernes dhe tradicionales, si dy forma të rëndësishme të jetës së përditshme sociale në Vushtrri. Këto dy forma paraqesin një bashkëjetesë kulturo-historike në mes vete edhe përkundër kundërthënieve eventuale si dhe nivelit të zbatueshmërisë që disa vlera të caktuara tradicionale mund të gjejnë sot. Duke u bazuar në realitetin e sotëm shoqëror, tradicionalja i ka shërbyer modernes si një udhërrëfyes dhe bazë për t'u ndërtuar vlerat e reja sociale.

Duke pasur parasysh individët që jetojnë në rrethana socio-historike të paqëndrueshme, me kalimin e kohës disa nga zakonet dhe besimet e gjeneratës së mëparshme, të cilat që dikur kanë qenë tejet të rëndësishme, tani më nuk gjejnë zbatim tek gjeneratat e reja. Traditat e dikurshme të paraardhësve tanë konsiderohen nga të rinjtë e të rejtat si më pak relevante duke mos përkuar me interesat dhe veprimet për brezin aktual. Kështu, një vend që vlerëson dhe mbron kulturën, traditën dhe çdo gjë që lidhet me të, është më e pasur për kah aspekti vleror. Megjithatë shoqëria e sotme është e gatshme për të adoptuar praktika dhe elemente të reja kulturore.

Pavarësisht proceseve jo të lehta që ka kaluar shoqëria, megjithatë ka arritur që t'i ruaj vlerat shoqërore dhe kulturore, të cilat janë vet kuptimi thelbësor i jetës, ngase njerëzit i përdorin ato si lloj udhëzime në jetën e tyre të përditshme. Vlerat sociale janë ato që kryesisht e përcaktojnë qëndrimin e individëve ndaj realitetit përreth tyre dhe që përcaktojnë modelin themelor të sjelljes sociale njerëzore.

Ky punim masteri përmban hyrjen, katër kapituj dhe konkluzionin

Në **hyrje** të këtij punimi është shtjelluar në mënyrë të përgjithshme rëndësia dhe impakti që ka tradicionalja dhe modernja në jetën e përditshme tek shoqëria. Janë bërë të ditura format dhe metodat e studimit, si rëndësia e këtij punimi për literaturën shkencore dhe shoqërinë në përgjithësi.

Kapitulli I– Modernja dhe Tradicionalja në qytetin e Vushtrrisë: Ky kapitull përmban një trajtim më të thellë të kuadrit teorik mbi lidhjen e tradicionales dhe modernes në përgjithësi në Vushtri. Në këtë mënyrë janë shqyrtuar tiparet relevante të stileve të jetesës së përditshme të shoqërisë vushtrriase, për të parë më thellësisht se ku qëndron roli dhe rëndësia e vlerave tradicionale në jetën moderne si dhe a vihen ende në zbatim. Përveç kësaj, janë vendosur në pah ndryshimet sociale për kohën, të cilat si rezultat, sollën modifikimin e vlerave tradicionale dhe gërshetimin e tyre me vlerat e reja moderne.

Kapitulli II- Identiteti Socio-Kulturor në Vushtri- Ky kapitull fokusohet në ndryshimet socio-kulturore të jetës urbane në qytetin e Vushtrrisë, lidhjet e tyre me identitetin socio-kulturor dhe atë fetar të saj. Identiteti socio-kulturor i Vushtrrisë së dikurshme vlerësohet shumë lart nga studiues e vizitorë të ndryshëm ndërkombëtarë, pikërisht për shkak të trashëgimisë së pasur kulturore, me theks të veçantë vlerave të anticitetit. Tiparet kolektive të identitetit socio-kulturor vërehen prej jetës së dikurshme kulturore në Vushtri, e cila ka qenë e pasur dhe e larmishme, duke vënë në konsideratë faktin që kohë më parë ka qenë e hapur *Shoqëria për kulturë* e emërtuar si *Vicianum*, e cila kishte hapur *Shkollën me drejtime të ndryshme*, duke filluar nga drejtimi për vallëzim, këndim, e deri tek drejtimi për aktrim. Duke mos lënë anash *Takimet e poeteshave shqiptare*, *Ansamblin kulturor të valleve*, dhe *Shoqatën çeshme*, të cilat përbëjnë një pjesë të rëndësishme të opusit kulturor të qytetit.

Kapitulli III- Impakti i Tenologjisë në Vlerat kulturore: Këtu trajtohet ndikimi i teknologjisë në sferën socio-kulturore dhe në shumë sfera sociale të jetës. Si rrjedhojë, e zhvillimit të hovshëm të teknologjisë është bërë i mundshëm promovimi më i gjerë i vlerave socio-kulturore kudo. Në anën tjetër, është rritur dukshëm dhe pabarazia sociale, si dhe diferencimi social mes individëve që nuk kanë çasje në të, prandaj shfaqen diferencimet sociale në mes të individëve, të cilët posedojnë të ardhura të ulta e një pjesë e tyre të ardhura të larta.

Pyetjet hulumtuese

- Cilat janë dallimet në mes tradicionales dhe modernes në qytetin e Vushtrrisë?
- Cilat janë vlerat e jetës urbane në Vushtri?
- Sa ka ndikuar tradicionalja në jetën e përditshme në Vushtri?

Metodologjia e punimit:

Në temën me titull: “Modernja dhe tradicionalja në jetën e përditshme në Vushtri” janë përdorur metodat kualitative dhe kuantitative duke përfshirë intervista gjysëm të strukturuar, me respondentë të moshave dhe profesioneve të ndryshme, duke aplikuar kështu edhe metodën krahasuese, fotografi të ndryshme, literaturë dhe hulumtime ekzistuese vendore dhe ndërkombëtare lidhur me temën “Modernja dhe tradicionalja në jetën e përditshme në Vushtri”. Janë realizuar tre intervista me njohës të mirë të identitetit social, kulturor, historik e fetar të Vushtrrisë. Informacionet e nxjerrura nga intervistat janë analizuar dhe përshtatur në kontekstin e temës, si dhe është bërë analizë krahasuese, në të cilën përfshihen mjete krahasimore të tradicionales dhe modernës dhe ndikimit të tyre në jetën e përditshme të Vushtrrisë. Tek metoda kuantitative është përdorur pyetësi, i cili përmbanë 12 pyetje të hapura, gjysëm të hapura dhe të mbyllura. Ky pyetësor përfshinë 150 respondentë, përmes së cilit janë nxjerrur të dhëna relevante sa i përket vlerave kulturore, tradicionale dhe moderne në qytetin e Vushtrrisë.